

VENDIM
Nr. 905, datë 18.11.2020

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR BASHKËPUNIMIN NË
FUSHËN E TRANSPORTIT HEKURUDHOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushën e transportit hekurudhor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, MBI BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E
TRANSPORTIT HEKURUDHOR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në vijim të quajtura “Palët”,

në bazë të Deklaratës së Përbashkët për Bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik të nënshkruar mes dy qeverive në Prizren, më 11 janar 2014;

me qëllim të avancimit të mëtejshëm të marrëdhënieve midis dy vendeve në fushën e transportit hekurudhor;

me dëshirën për të krijuar një kuadër të qëndrueshëm për bashkëpunim në të ardhmen ndërmjet të dy vendeve në fushën e transportit hekurudhor,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi këtij Memorandumi Bashkëpunimi është të krijojë një kuadër bashkëpunues për organizimin e transportit hekurudhor, duke:

- kryer aktivitetet e organizimit të transportit kufitar hekurudhor të një Pale në territorin e shtetit të Palës tjetër;

- vendosur rregullat për organizimin e transportit kufitar hekurudhor të njëres Palë në trenat të cilët lëvizin në territorin e shtetit të Palës tjetër.

Neni 2
Fushat e bashkëpunimit

1. Palët angazhohen të bashkërendojnë politikat e transportit hekurudhor për rajonet kufitare, por duke mos u kufizuar edhe për rajonet e tjera me specifika të ngjashme, si dhe të nxisin pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të interesit në identifikimin e fushave dhe projekteve të përbashkëta në fushën e transportit hekurudhor.

2. Palët angazhohen për të siguruar mbështetjen e duhur financiare dhe logjistike për hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta, duke aplikuar bashkërisht ose veçmas pranë institucioneve financiare për këtë mbështetje.

Neni 3

Përgjegjësitë e palëve

Palët bien dakord, që:

1. Të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë për hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta në fushën e transportit hekurudhor.

2. Të mundësojnë lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve dhe të mallrave, duke i dhënë prioritet transportit hekurudhor në zona të caktuara.

3. Të zhvillojnë takime për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët.

Neni 4

Shkëmbimi i ekspertëve

Palët angazhohen për caktimin dhe shkëmbimin e ekspertëve për negociim dhe diskutim, sipas nenit 3 këtu më sipër, duke ndihmuar dhe mbështetur bashkërisht njëra-tjetrën, për përmbushjen e qëllimit të këtij memorandumi në fushën e transportit hekurudhor.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që lindin midis Palëve nga interpretimi ose zbatimi i këtij Memorandumi, do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve nëpërmjet konsultimeve.

Neni 6

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi 30 ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të së cilave Shtetet Palë konfirmojnë përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të këtij Memorandumi, përveç se kur njëra nga palët informon palën tjetër me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për qëllimin e përfundimit të këtij Memorandumi.

Hartuar në Tiranë, më 2.10.2020 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

EDI RAMA

KRYEMINISTËR

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

AVDULLAH HOTI

KRYEMINISTËR